



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 korrik 2026

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit dhe Caktimin e Datës
për Shqiptimin e Aktgjykimit**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), mbi bazë të neneve 21(4)(d), 40(2) dhe 43(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 116(1), 158(1) dhe 159(1) dhe (2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 shkurt 2026, pasi dëgjoi deklaratat përmbyllëse të palëve dhe Mbrojtjes së Viktimave, si dhe deklaratat e të akuzuarve,¹ Kryegjykatësi e deklaroi çështjen gjyqësore të mbyllur mbi bazë të rregullës 136(1).²
2. Më 5 maj 2026, Trupi Gjykues lëshoi urdhër për zgjatjen e afatit për shqiptimin e Aktgjykimit ("Urdhri për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit").³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Sipas nenit 43(2), vendimi i gjykimit merret nga shumica e gjykatësve të Trupit Gjykues dhe shpallet publikisht. Aktgjykimit të Trupit Gjykues i bashkëngjitet një arsyetim me shkrim.
4. Sipas rregullës 158(1), pas mbylljes së çështjes, Trupi Gjykues tërhiqet për të kuvenduar *in camera* për shqiptimin e vendimit të gjykimit në lidhje me akuzat e aktakuzës.
5. Sipas rregullës 159(1), vendimi i gjykimit shqiptohet brenda nëntëdhjetë (90)

¹ Transkripti i seancës, 9 shkurt 2026, f. 28357-28491; Transkripti i seancës, 10 shkurt 2026, f. 28492-28560; Transkripti i seancës, 11 shkurt 2026, f. 28561-28720; Transkripti i seancës, 12 shkurt 2026, f. 28721-28856; Transkripti i seancës, 13 shkurt 2026, f. 28857-29007; Transkripti i seancës, 16 shkurt 2026, f. 29008-29147; Transkripti i seancës, 18 shkurt 2026, f. 29148-29237.

² Transkripti i seancës, 18 shkurt 2026, f. 29238, rreshtat 23-24.

³ F03730, Trupi Gjykues, *Urdhër për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit*, 5 maj 2026.

ditësh pas mbylljes së çështjes gjyqësore sipas rregullës 136. Gjithashtu, në qoftë se rrethanat e çështjes kërkojnë zgjatje të mëtejshme të afatit, kjo nuk shkon më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë, përveçse kur është absolutisht e nevojshme. Vendimi për zgjatjen e afatit është publik, palët dhe Mbrojtja e Viktimave informohen në lidhje me të, dhe në të jepen arsyet për zgjatjen e afatit.

6. Sipas rregullës 159(2), vendimi i gjykimit, ose një përmbjedhje e këtij vendimi, shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës dhe në praninë e të akuzuarit, përveçse kur rrethana të posaçme përlligjin mungesën e të akuzuarit.

III. DISKUTIM

A. ZGJATJA E AFATIT PËR SHQIPTIMIN E AKTGJYKIMIT

7. Trupi Gjykses rikujton se, në përputhje me rregullën 159(1), zgjati afatin për shqiptimin e Aktgjykimit deri **të hënën, 20 korrik 2026**.⁴

8. Trupi Gjykses rikujton se, në përputhje me rregullën 159(1), në qoftë se rrethanat e çështjes kërkojnë zgjatje të mëtejshme të afatit, mund të vendosë për zgjatjen e afatit për shqiptimin e Aktgjykimit, që nuk shkon më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë, përveçse kur është absolutisht e nevojshme.

9. Trupi Gjykses gjykon se një zgjatje e mëtejshme e afatit është absolutisht e nevojshme brenda kuptimit të rregullës 159(1). Trupi Gjykses, siç përcaktohet në Urdhrin për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit, rikujton se: (i) mori dëshmitë e afërsisht 270 dëshmitarëve (me gojë dhe me shkrim);⁵ (ii) pranoi si prova 5.467 prova materiale;⁶ (iii) numri i faqeve të transkripteve të seancave të këtij procesi gjyqësor është 29.238 faqe;⁷ dhe (iv) rikujton kompleksitetin e procesit

⁴ Urdhri për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit, para. 8, 10.

⁵ Urdhri për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit, para. 6.

⁶ Urdhri për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit, para. 6.

⁷ Urdhri për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit, para. 6. *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 18 shkurt 2026, f. 29238.

në këtë çështje gjyqësore, konkretisht se faktet e çështjes mbulojnë një periudhë më të gjatë se një vit e gjysmë dhe përfshijnë vende të shumta ku pretendohet se janë kryer krime dhe një numër të konsiderueshëm incidentesh individuale.⁸ Gjithashtu, procesi lidhet me akuza kundër katër të akuzuarve, përgjegjësia e të cilëve duhet të vlerësohet individualisht dhe me kujdes. Bazuar në sa më lart, që të mund të kryejë një vlerësim të plotë dhe të drejtë të provave dhe të japë mendim të arsyetuar si duhet që merr parasysh vëllimin e konsiderueshëm të provave dhe kompleksitetin e procesit, Trupi Gjykses është bindur se një zgjatje e mëtejshme e afatit është absolutisht e nevojshme.

10. Trupi Gjykses pranon se, mbi bazë të nenit 21(4)(d), të akuzuarit kanë të drejtën të gjykohen brenda një kohe të arsyeshme. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm për kohën që të akuzuarit kanë kaluar tashmë në paraburgim dhe për nevojën që procesi të vijojë sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, Trupi Gjykses është bindur se një zgjatje e mëtejshme e periudhës me pak më pak se 60 ditë, nuk do të dëmtojë në mënyrë të papërligjur të akuzuarit. Zgjatja e afatit për ligjet nga nevoja për të kryer një vlerësim të drejtë, tërësor dhe të arsyetuar të provave të administruara dhe nga kriteri për dhënien e një mendimi të arsyetuar me shkrim që pasqyron me saktësi provat e administruara. Trupi Gjykses është bindur se asnjë zgjatje më e shkurtër e afatit nuk do t'i mundësonte Trupit Gjykses të përmbushë si duhet përgjegjësitë e veta.

11. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, një zgjatje e mëtejshme e afatit prej pak më pak se 60 ditësh është absolutisht e nevojshme dhe zgjat afatin për shqiptimin e Aktgjykimit deri të **mërkurën, 16 shtator 2026.**

⁸ Urdhri për Zgjatjen e Afatit për Shqiptimin e Aktgjykimit, para. 6; *Shih p.sh.*, F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, konfidenciale, para. 16; Listat A-C.

B. CAKTIMI I SEANCËS PËR SHQIPTIMIN E AKTGJYKIMIT

12. Trupi Gjykses vëren se, në përputhje me rregullën 159(2), Aktgjykimi, ose një përmbledhje e tij, do të shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës, dhe në prani të të akuzuarve, përveç nëse rrethana të posaçme përligjin mungesën e tyre.

13. Trupi Gjykses vlerëson se caktimi në këtë moment i një date për shpalljen e Aktgjykimit, siguron njoftim të drejtë dhe në kohë për të gjithë personat e përfshirë.

14. Bazuar në sa më lart, për mbajtjen e seancës për shqiptimin e Aktgjykimit Trupi Gjykses cakton **të mërkurën, 16 shtator 2026 në orën 10:00**.

IV. VENDIM

15. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses:

- a) **ZGJAT** afatin për shqiptimin e Aktgjykimit deri **të mërkurën, 16 shtator 2026**; dhe
- b) **CAKTON të mërkurën, 16 shtator 2026, në orën 10:00** për mbajtjen e seancës publike për shqiptimin e Aktgjykimit.

/nënshkrimi/
Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E mërkurë, 1 korrik 2026

Në Hagë, Holandë.